



Pranuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	29-01-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Ni Prot Bi Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSHXK	352/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A Nr. 406/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 406/2020 të datës 08.12.2020, të parashtruar nga grup ankuesish

kundër Vendimit me Nr.Prot:1088 të datës 02.12.2020, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike " kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.01.2021, mori këtë;

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.Nr.406/2020 të datës 08.12.2020, të parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit dhe
me datë 08.12.2020 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokolli 3015/2020, e regjistruar me numër A.nr.406/2020, kundër Vendimit Nr.Prot:1088 të datës 08.12.2020, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 14.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë së Kosovës . Këshilli më datë 18.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministri, se bashku me shkresat e bashkëngjitura.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, me kërkesë të Kryetares së Kolegjit, më datë

18.01.2020 ka nxjerr Vendimin VK.nr.2/2021 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.406/2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 406/2020, të datës 08.12.2020, Vendimin me Nr.Prot.1088 të datës 02.12.2020, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.03/03 të datës 19.02.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; shkresën e datës 14.04.2020 drejtuar Kryeministrit të Kosovës, Kërkesën e datës 12.05.2020, drejtuar Këshillit për pozita të nivelit drejtues, kërkesën e datës 28.08.2020; drejtuar Kryeministrit të Kosovës, kërkesën për emërim të datës 06.10.2020, Njoftimin me nr.ref 693/2020 të datës 28.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshme të MPB, Vendimin Nr. 1050, 1064, 1053, 1058, 1057, 1051, të datës 27.11.2020 dhe vendimi nr. 30.11.2020, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Përgjigje në ankesës e datës 18.12.2020, me numër protokolli 3203/2020, me shkresat e bashkangjitura, Vendimin Nr.07/23 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 13.07.2011, Vendimin Nr.10/194 të datës 23.07.2014, Vendimin 12/149 të datës 17.07.2017, Vendimin Nr. 867 të datës 19.02.2020 të Ministrit të MBPZHR, shkresën zyrtare me Nr.Prot:2843 të datës 16.07.2020, Vendimin Nr.10/18 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 08.06.2011, Vendimin Nr.08/194 të datës 23.07.2014, Vendimin Nr.06/150 të datës 17.07.2017, Vendimin me Nr.10/150 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.07.2017, parashtresën me nr. Protokolli 1681 të datës 23.07.2020, nga Ministri i MASH drejtuar Këshillit për Emërim në Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, Vendimin Nr.06/151 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin Nr.05/194 të datës 23.07.2014, Vendimin Nr.13/149 të datës 17.07.2017, Vendimin Nr.08/22 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin Nr.04/194 të datës 23.07.2014, Vendimin Nr. 06/151 të datës 02.08.2017, Vendimin Nr.09/20 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 22.06.2011, Vendimin Nr.07/194 të datës 23.07.2014, Vendimin Nr.09/149 të datës 17.07.2017, Vendimin Nr.06/32 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 10.08.2011, Vendimi Nr.13/194 të datës 23.07.2014, Vendimi Nr.09/150 të datës 17.07.2017, Listën me pozita të lira në institucione publike nga Zyra e Kryeministrit të datës 11.12.2020, e-mailin nga DMZP të datës 13.01.2021, e-mailin nga DMZP të datës 20.01.2021, Vendimin Nr.1137 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr. Prot:1139 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr.1142/2020 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr.1133/2020 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr.1136/2020 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr.1143/2020 të datës 15.12.2020, Vendimin Nr. Prot:133/2021 të datës 19.01.2021, përgjigjen në ankesë të datës 18.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që janë plotësuar kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ i filluar me ankesën A.nr. 406/2020 të datës 08.12.2020, *sepse:*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendojnë se Vendimi Nr.Prot:1088 i datës 02.12.2020, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, është i paligjshëm për arsye se bazuar në nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme është e detyruar që pas përfundimit të mandatit, ti sistemoj nëpunësit e lartë drejtues në një pozitë të kategorisë se mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloi vendimin Nr.1088 të datës 02.12.2020, të Drejtorit të DMZP-së, dhe të obligoj MPB-në për zbatimin e vendimeve të anuluar me vendimin Nr.1088 të datës 02.12.2020.

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji, ka gjetur se: Ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për tri mandate radhazi në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, përkatësisht nga data 13.07.2011, deri me 17.07.2020. Ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik(MZHE) për tri mandate radhazi në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh respektivisht nga data 08.06.2011 deri me 17.07.2020. Me vendimin Nr. 03/03/2020 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Kosovës, ankuesi _____ në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në MZHE, ka kaluar në listën tepricë, për arsye se kjo ministri është prekur nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), nga data 21.07.2017, deri me datë 21.07.2020. Ministri i MASHT-it, me datë 23.07.2020 përmes parashtrësës me nr.Prot:1681, i është drejtuar Këshillit për Emërime në Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, më kërkesë që ti vazhdohet mandati ankuesit në pozitën e Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, por Qeveria e Kosovës nuk ka vë në shqyrtim këtë kërkesë. Ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), për tri mandate radhazi, në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, përkatësisht nga data 25.05.2011 deri me datë 17.07.2020. Po ashtu ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH), për tri (3) mandate radhazi në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, respektivisht nga data 06.07.2011 deri me datë 02.08.2020. Me vendimin Nr. 03/03/2020 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Kosovës, ankuesi _____ në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPH, ka kaluar në listën tepricë, për arsye se kjo ministri është prekur nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave (MF) për tri (3) mandate radhazi respektivisht nga data 22.06.2011 deri me 17.07.2020. Me Vendimin Nr. 03/03/2020 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Kosovës, ankuesi _____ në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në MF ka kaluar në listën tepricë, për arsye se kjo ministri është prekur nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërsa ankuesi _____ ka ushtruar detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, për tri (3) mandate radhazi në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, përkatësisht nga data 10.08.2011 deri me datë 17.07.2020.

Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë bazuar në Listën e datës 11.12.2020, për pozita të lira në institucionet publike, të dërguara nga Zyra e Kryeministrit, ka bërë sistemimin e ankueseve në pozita të nivelit të mesëm drejtues dhe atë: me Vendimin Nr.Prot.1050 të datës 27.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Pensioneve/MPMS, Kodi MSP/020, me Vendimin Nr.Prot.1064, të datës 30.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Turizmit/MTI, Kodi TI/840, me Vendimin Nr./2020 të datës 27.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer/MI, Kodi AI/540, me Vendimin Nr.Prot.1053, të datës 27.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Arsim të Lartë/MASH, Kodi AR/020, me Vendimin Nr.Prot.1058 të datës 27.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave/MEZHR, Kodi IE/010, me Vendimin Nr.Prot. 1057 të datës 27.11.2020, ankuesi _____ është emëruar në pozitën e Drejtorit të

Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Kodi AD/010, si dhe me Vendimin Nr.Prot 1051 të datës 27.11.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Arsimit Para Universitar/MASH, Kodi AR/010.

Ndërsa, me datë 02.12.2020 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me vendimin Nr. Protokoli 1088 ka shfuqizuar vendimet Nr.Prot: 1050, 1051, 1052, 1053, 1054, 1056, 1057, 1058, të datës 27.11.2020 dhe vendimin Nr. Prot:1064 të datës 30.11.2020, me arsytim se disa institucione janë në fazën e ristrukturimit të brendshëm për shkak të bashkimit të disa ministrive, ku shumë pozita do të shuhen, e që do të kenë efekt tek nëpunësit civilë, disa institucione edhe pse kanë deklaruar pozita të lira këto pozita kanë zëvendësues, e disa institucione nuk kanë mbulesë buxhetore për plotësim të pozitave të lira. Kundër këtij vendimi ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshill me datë 08.12.2020, me pretendimet e cekura si me lartë.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, përkatësisht me datë 13.01.2021 dhe 20.01.2021, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë lidhur me ri sistemimin e ankuesve, në pozita të nivelit të mesëm drejtues, ashtu që ankuesi me vendimin Nr.1137 të datës 15.12.2020, është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftë, Kodi MSP/030, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me Vendimin Nr.1139 të datës 15.12.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor, Kodi LI/8010, në Ministrinë e Shëndetësisë, me Vendimin Nr.1142/2020 të datës 15.12.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Arsim dhe Aftësim Profesional, Kodi AR/1220, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me Vendimin Nr.1133/2020 të datës 15.12.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Kodi AD/010, në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave/MPB, me Vendimin Nr.1136/2020 të datës 15.12.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Mbështetjes, Kodi MM/1110, në Ministrinë e Mbrojtjes, me Vendimin Nr.1143/2020 të datës 15.12.2020, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Kimi Biologji Forenzikë, Agjencia e Kosovës për Forenzikë/MPB, me Vendimin Nr. Prot:133/2021 të datës 19.01.2021, ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Koordinim me Zyrat Regjionale, Kodi BVP/1180, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Sipas njoftimit të datës 13.01.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesit kanë filluar punën në pozitat e emëruara, ndërsa ka bërë kërkesë për lirim nga Shërbimi Civil, nga dhe i është lëshuar Vendimi për përfundim të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.

Andaj, meqenëse objekti i ankesës ka qenë sistemimi i ankuesve në pozita të nivelit të mesëm drejtues, si dhe pas konstatimit se gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ka sistemuar ankuesit në pozita të nivelit të mesëm drejtues, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Nga ajo që u tha më lartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A. Nr. 406/2020

Rushit KAJTAZI

Zyrtar për bashkëpunim profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve;
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

